



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /
Ministry of Culture, Youth and Sports

Kabineti i Ministrit
Kabinet Ministra
Minister's Office

Nr. 69 /2016
Datë: 10.10.2016

Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Kujtim Shala, në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 4, 21, 22 të Ligjit Nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, Nr. 82, 21 tetor 2012), duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) dhe Shtojcën 7 (shtatë) të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22 mars 2011) dhe u mbështetur në nenin 4 të Ligjit Nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore, Rregulloren 05/2008 mbi Regjistrimin, Dokumentimin, Vlerësimin dhe Përzgjedhjen e Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje, gjegjësisht, neni 2 dhe neni 4 i kësaj Rregulloreje. si dhe duke marr për bazë propozimin e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore më Nr. të datës 10/10/2016 në lidhje me propozimet e shqyrtuara dhe të rekomanduara për përfshirje të objekteve të trashëgimisë kulturore në Listën për Mbrojtje të përhershme, mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Lista e aseteve të Trashëgimisë Kulturore për Mbrojtje të përhershme, sipas propozimeve të shqyrtuara nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore për përfshirje të këtyre aseteve në Listën e objekteve me status të mbrojtjes së përhershme.
2. Lista e aprovuar si në pikën një (1) të këtij Vendimi, përfshin njëzet e tre (23) asete të trashëgimisë kulturore, respektivisht:
 - 2.1. Kisha e Shën Premtës (Kisha e Levishës);
 - 2.2. Manastiri i Deçanit;
 - 2.3. Manastiri i Graçanicës;
 - 2.4. Patrikana e Pejës;

- 2.5. Xhamia e Mbretit;
- 2.6. Shtëpi banimi (ish Akademia e Shkencave dhe Arteve);
- 2.7. Shtëpi banimi (IMMK);
- 2.8. Kompleks banimi (Emin Gjiku) Muzeu Etnologjik;
- 2.9. Kompleksi Xhamia e Hadumit;
- 2.10. Kulla e Haxhi Zekës (Kullë shqiptare e Jashar Pashës);
- 2.11. Xhamija e Sinan Pashës;
- 2.12. Hidroelektrana-Muzeu i Elektroekonomisë;
- 2.13. Hamami i Gazi Mehmet Pashës;
- 2.14. Kishë dhe Shkollë fillore në gjuhën shqipe;
- 2.15. Kështjella “kalaja” Kulla e vjetër;
- 2.16. Kalaja e Harilaqit;
- 2.17. Municipium Ulpiana-Justinia Secunda;
- 2.18. Lokaliteti arkeologjik “qyteza”
- 2.19. Kalaja e Prizrenit;
- 2.20. Lokaliteti arkeologjik “Fusha e madhe dhe Tuma”
- 2.21. Qyteza e fortifikuar në Veletin-Shashkoc;
- 2.22. Gërmadha e Kalasë së Korishës;
- 2.23. Kalaja e antikitetit të vonë në Keqekollë.

3. Këtij Vendimi i bashkangjitet edhe Lista e cila konsiderohet pjesë përbërëse e këtij vendimi.

4. Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrisë
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
- Komunave;
- Departamentit të Trashëgimisë Kulturore;
- Institucioneve të trashëgimisë kulturore në vartësi të MKRS-së;
- Pronarëve;
- Agjensionit Kadastral të Kosovës;
- Departamentit Ligjor;
- Arkivit të MKRS-së;

Kultrim SHALA
Ministër

